



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

**Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural/Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva
i Ruralnog Razvoja/Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development**
Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë/Agencije za Razvoj Poloprivrede/ The Agriculture Development Agency

Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë , mbështetur në Ligjin nr. 03/L-149, për “Shërbimin Civil në Republikën e Kosovës”, dhe Rregullores nr. 02/2010, “Për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil”, me qëllim të realizimit të procedurave të rekrutimit shpall:

KONKURS (i Brendshëm)

Titulli i pozitës: Drejtor i Drejtorisë për Pagesa Direkte

Ref: RN00002453

Njësia Organizative: Drejtoria e Administratës - AZHB

Vendi i punës: Prishtinë

Kategoria funksionale: Niveli drejtues

Koeficienti: 10

Qëllimi i vendit të punës:

Qëllimi i punës së Drejtorit të Drejtorisë për Pagesa Direkte është për të organizuar, menaxhuar dhe koordinuar punët në drejtori në procesin e implementimit të programit për Pagesa Direkte.

Menaxhon shqyrtimet administrative të aplikacioneve për Pagesa Direkte, kalkulimet dhe ekzekutimet e pagesave si dhe menaxhimin dhe koordinimin e aktiviteteve në lidhje me përgatitjen e dokumentacionit për aplikim për Pagesa Direkte.

Detyrat kryesore:

- 1.Udhëheqë dhe cakton objektivat e drejtorisë në përputhje me strategjinë dhe objektivat e AZHB-se dhe dizajnon planet vjetore të punës të detajuara për të përmbushur këto objektiva 20%
- 2.Menaxhon stafin dhe buxhetin e drejtorisë dhe organizon punën përmes ndarjes së detyrave tek të varurit e tij, ofron udhëzime dhe monitoron punën e stafit;15 %
- 3.Analizon dhe vlerëson proceset dhe procedurat e brendshme duke përgatitur raporte për rezultatet e përkrahjes dhe rekomandon ndryshime, përmirësime me qëllim të rritjes së efikasitetit në punë; 15%
- 4.Ekzekutimi i skemave të Pagesave Direkte në pajtim me programin vjetor duke bërë analizën e rrishtit dhe përzgjedhjen e mostres për kontroll në terren ;15%
5. Organizimi dhe mbikqyrja e procesit të aplikimit dhe Menaxhimin i vlerësimit-shqyrtimit administrativ të aplikacioneve të fermerëve dhe miratimin dhe autorizimin e Pagesave Direkte; 10%
- 6.Mbështet përgatitjen e udhëzimeve administrative, rregulloreve dhe rregullave për përkrahje në koordinim me Sektorin Ligjor të AZHB-së; 10%
- 7.Përgatitja e materialeve për informim dhe udhëzuesve për fermerët në koordinim me DSHK 10%
8. Bën vlerësimin e stafit dhe përkrah zhvillimin e tyre përmes trajnimeve; 5%

Kualifikimet dhe shkathtësitë e kërkua:

Njohuri paraprake ne fushën e pagesave direkte;

Diploma Universitare: **Shkenca të Ekonomisë, Bujqësi ose Relevante;**

Përvoja në punë: 6 vite përvojë pune profesionale - 3 vite përvojë në vende udhëheqese; Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve(Ëord, Excel, Poëer Point,Access)

Fleksibilitet dhe aftësi për t'u përballë me situata të reja;

Shkathtësi ne menaxhim, organizim, caktim te objektivave dhe planifikim;

Njohja e gjuhës angleze e preferuar.

Data e shpalljes së konkursit me: 14.12.2017

Data e mbylljes së konkursit me: 21.12.2017

“Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

“Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale, siç specifikohet në Nenin 11, paragrafin 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës

Aplikacionet e dorëzuara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Aplikacionet e pakompletuara refuzohen.

Për shkak të numrit të madh të aplikacioneve të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Procedura e Aplikimit: Formularët për aplikim mund të merren dhe dorëzohen në Sektorin e Personelit në Agjencionin për Zhvillimin e Bujqësisë - M B P Z H R , Ndërtesa e Bankës së Lublanës Kati i VII , Zyra nr. 23 ose të shkarkohen në adresën e internetit të AZHB-së www.azhb-ks.net.